**1 UP LABS SHPK**
ADRESA: RRUGA THEMISTOKLI GERMENJI, TIRANE
NIPT M02102002A

# KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Sot më datë 07/01/2022 u paraqitën personalisht palët kontraktuese si më poshtë:

## NENI 1

### Palët kontraktuese

1. Z.**Enjan Gazhga**, shtetas shqiptar, lindur më 30.11.1981 në Tiranë dhe banues në Tirane, i identifikuar nga Letërnjofitmi Nr. Personal BB7044511, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me zotësi juridike, nga këtu e më poshtë referuar si Shitësi:

Dhe,

2. Z. **Klaudian Dhefto**, shtetas shqiptar, lindur më 05.09.1979 në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me Nr. Personal H90905124F, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, që këtu e më poshtë do të quhet Blerësi.

## NENI 2

### Objekti i kontratës

2.1 Objekti i Kontratës është shitja e 20% (njëzet përqind ) të kuotave të kapitalit, që shitësi zotëron në Shoqërinë "1 UP Labs Shpk" ndaj blerësit përkundrejt cmimit të përcaktuar:

2.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate struktura e pronësisë mbi kapitalin themeltar të shoqërisë do të jetë:

| ORTAKËT | Përqindja e pronësisë mbi Kapitalin |
|---|---|
| Z.ENJAN GAZHGA | 80% |
| Z.KLAUDIAN DHEFTO | 20% |
| | |

**NENI 3**

**CMIMI I SHITJES**

**3.1** Cmimi total i shitjes së kuotës që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është 20.000 (njëzet mijë) Lekë.

**NENI 4**

**Mënyra e pagesës**

**4.1** Palët deklarojnë që cmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate do të likujdohet nga blerësi përmes transfertës bankare në llogarinë bankare të shitësit.

**NENI 5**

**Të drejtat dhe detyrimet e Palëve**

**5.1** Shitësi garanton se kuota/pjesët e kapitalit objekt i kësaj kontrate nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonje lloj tjetër barre, dhe se ai është i vetmi pronar i tyre dhe gëzon të drejta të plota mbi to.

**5.2** Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotën e transferuar sipas objektit të kontratës.

**5.3** Shitësi do të paguajë të gjitha detyrimet /taksat e parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar në lidhje me këtë kontratë.

**5.4** Me hyrjen në fuqi të kësaj kontrate Blerësi bëhet zotërues i kuotës prej 20% të kapitalit.

**NENI 6**

**Regjistrimi i transferimit të kuotës**

**6.1** Vlefshmëria e transferimit të pronësisë mbi kuotën objekt i kësaj kontrate nuk kushtëzohet nga formalitetet e regjistrimit apo të miratimit nga organet kompetente përkatëse.

**1 UP LABS SHPK**

ADRESA: RRUGA THEMISTOKLI GERMENJI, TIRANE

NIPT M02102002A

**6.2** Me nënshkrimin e kësaj kontrate palët marrin përsipër të evitojnë cfarëdolloj veprimi apo mosveprimi i cili mund të pengojë zbatimin e dispozitave të kësaj kontrate.

**6.3** Kjo kontratë nënshkruhet në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të statusit të shoqërisë.

**NENI 7**

**Hyrja në fuqi e kontratës**

**7.1** Kjo kontratë u hartuaa ne 2(dy) ekzemplarë me fuqi të njëjtë ligjore.

**7.2** Kjo kontatë hyn në fuqi menjëherë.

SHITËSI

BLERËSI

1UP LABS SH. P. K.
one up
DIGITAL & MORE
NUIS: M02102002A